

HAP PAS HAPI

Trajnimi avansues për edukatorë që punojnë me fëmijë të moshave 3-6 vjeç

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve të përgjithshme filozofike* dhe bazën teorike të *programit me në qendër fëmijën*
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike* në klasë
- Aftësi për *organizimin e mësimit kooperativ* që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm
- Aftësi për *planifikimin e mësimit tematik* me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës* dhe *vlerësimin e efekteve* të punës në klasë
- Aftësi për *aplikimin e teknikave të përshtatshme* të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përbajtjet e ndryshme programore
- Ide për krijimin e një *ambienti stimulus* për *mësimnxënien aktive*

- Njohuri për *përfshirjen e familjes* në realizimin e programit

Përmbajtja e trajnimit avansues për klasën e parë

Individualizimi, planifikimi global, planifikimi mëjor-javor, planifikimi ditor, dita e balancuar, vëzhgimi, dokumentimi, vlerësimi, përfshirja e familjes, prezemntimi i librit (matematika, blloqet, shkenca, lezin-shkrimi prezantimi i librit, arti figurativ, familje-dramatizimi, rëra dhe uji).

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet edukatorëve të cilët punojnë me fëmijë të moshave 3-6, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi avansues për edukatorë realizohet me anë të një trajnimi 5 ditorë që përfshin gjithsej 40 orë. Ky trajnim pasohet me 4 punëtori një ditore gjatë një viti akademik.

Me qëllim që të përcillet puna në kontinuitet dhe të punohen sa më shumë në cilesi të punës çdo muaj parashifen monitorime në klasë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnime.